



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 08.05.2019, ora 09:30

Drejton mbledhjen: Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i vendimeve nr. 224, datë 27.04.2019 dhe nr. 245, 246 dhe 247, datë 07.05.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, në qarkun Berat, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë” dhe “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike për qarqet Tiranë, Durrës dhe Korçë për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë” si dhe verifikimi i mandatit të deputetëve z. Klajdi Qama, z. Indrit Hoxha, z. Kujtim Gjuzi dhe z. Koçi Tahiri.

Marrin pjesë:

Gramoz Ruçi, Vasilika Hysi, Klotilda Bushka, Ermonela Felaj

Mungojnë:

Ulsi Manja dhe Damian Gjiknuri

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi – Fillojmë mbledhjen e sotme të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin.

Nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve janë depozituar në Kuvend vendimet për dhënien e mandatit të deputetëve të kandidatëve të listës shumëemërore të Partisë Demokratike në qarqet Tiranë, Durrës dhe Korçë, Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, në qarkun Berat.

Në mbështetje të nenit 13 të Rregullores, Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin verifikon mandatin e deputetit, i cili zgjidhet gjatë legjislaturës dhe paraqet raportin përkatës në seancë plenare brenda 30 ditëve. Kandidatëve që kanë fituar mandatin e deputetit janë konkretisht:

- Z. Klajdi Qama, shpallur deputet i Kuvendit të Shqipërisë me vendimin nr. 224, datë 27.04.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me subjekt politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Berat.

- Z. Indrit Hoxha, shpallur deputet i Kuvendit të Shqipërisë me vendimin nr. 245, datë 07.05.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me subjekt politik Partia Demokratike, Qarku Tiranë.

- Z. Kujtim Gjuzi, shpallur deputet i Kuvendit të Shqipërisë me vendimin nr. 246, datë 07.05.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me subjekt politik Partia Demokratike, Qarku Durrës.

- Z. Koçi Tahiri, shpallur deputet i Kuvendit të Shqipërisë me vendimin nr. 247, datë 07.05.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me subjekt politik Partia Demokratike, Qarku Korçë.

Siç jeni në dijeni, si rezultat i dorëheqjeve të deputetëve të opozitës, nga mandati i deputetit. Kuvendi, në mbështetje të nenit 164 të Kodit Zgjedhor, i është drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për ta njoftuar për vakancat e krijuara.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimet e mësipërme, nr. 224, 245, 246, dhe 247 i ka dhënë mandatin e deputetit kandidatëve vijues të listave respektive. Vendimet i keni të gjithë përpara.

A ka ndonjë mendim, ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim nga anëtarët e Këshillit, në lidhje me mandatin e deputetëve të ri?

Nuk ka.

Atëherë, jemi dakord!

Anëtarët e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin janë dakord me vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Znj. Klotilda Bushka ta paraqesë në seancë raportin, siç është rregulli, i cili shpreh këtë qëndrim të Këshillit, i cili do të votohet nga seanca.

Mirupafshim! Mbledhja mbyllet.

MBLEDHJA MBYLLET